



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2023:034814

Datë: 12.03.2024

Numri i dokumentit: 05441599

**NË EMËR TË POPULLIT**

**P.nr.88/2023**

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË** - Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtari Xhemajl JUSUFI, me zyrtare ligjore Doruntina BEKA, në lëndën penale ndaj të pandehurit D....V....., për shkak të veprës penale: Rrezikimi i trafikut publik nga neni 370 paragrafi 9 lidhur me paragrafin 6 dhe 1 të Kodit Nr. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës (*tutje si: KPRK*), sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.1591/22 (2022:0055446) të datës 13.02.2023, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datë 28.02.2024 në prezencë të Prokurorit të Shtetit Arjan Xhema, të pandehurit D....V....., mbrojtësit të pandehurit sipas autorizimit me shkrim, avokat Shyqyri Sylja si dhe të dëmtuarit B....V....., me datë 04.03.2024, në mungesë të palëve, mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 12.03.2024 përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

I pandehuri:

D....V....., nga i ati S....., e ëma V....., e gjinisë M....., i lindur me datën 06.02.2001, në Mitrovicë, ku edhe tani jeton në Rr. "Sh.... P....", lagje T....., me numër personal ....., punon në firmën "Th.. R...." si teknik i operimeve, i pamartuar, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

**ËSHTË FAJTOR**

Sepse:

Me datë 03.08.2022, rreth orës 19:03 minuta, në rrugë "Sh.... P...." në Mitrovicë, derisa i pandehuri D....V..... ishte duke drejtuar automjetin e markës Mercedes me ngjyrë e zezë me targat ....., nga pakujdesia shkel Ligjin për Rregullat e Trafikut Rrugor nga neni 41, pa u bindur se nuk i rrezikon ose nuk i pengon pjesëmarrësit e tjerë në trafik ose nuk e rrezikon pasurinë, derisa ishte i ndalur në trotuar ashtu vazhdon të lëviz mbrapa duke e shfrytëzuar rrugën "Z... R...." dhe me pjesën e prapme e godet biçiklistin, të ndjerin E.... V.... e duke e futur ndër automjet, me ç' rast i dëmtuari i ndjeri E.... V.... për shkak të lëndimeve të marra dërgohet me urgjencë në spitalin rajonal të Mitrovicës ku si pasojë e këtyre lëndimeve, ndërron jetë.

**Me këtë ka kryer veprën penale, Rrezikimi i Trafikut Publik nga neni 370 paragrafi 9 lidhur me paragrafin 6 dhe 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.**

Andaj, Gjykata në bazë të nenit 1, 4, 7, 17, 23, 38, 39, 46, 47, 48, 49, 69, 70, 71, 72 dhe 370 të KPRK-së dhe nenit 364, 449, 450, 452 dhe 460 të KPP-së, i:

## S H Q I P T O N

- I. Dënim me burgim në kohëzgjatje prej tetë (8) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri nuk kryen veprë tjetër penale në periudhën e verifikimit prej një (1) viti nga plotfuqishmëria e këtij Aktgjykimi.
- II. Obligohet i pandehuri që t'i paguajë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, në emër të ekspertizës së komunikacionit, shumën prej 300.00 (*me fjalë: treqind*) euro, në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 30 euro, ndërsa në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej 20 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.
- III. I dëmtuari B....V.... ka hequr dorë nga kërkesa pasurore juridike.

## A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.1591/22 të datës 13.02.2023 ndaj të pandehurit D....V....., për shkak të veprës penale: Rrezikimi i trafikut publik nga neni 370 par.9 lidhur me par.6 dhe 1 të KPRK-së

Gjykata ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datë 28.02.2024, në të cilën kanë qenë të pranishëm Prokurori i Shtetit Arjan Xhema, i akuzuari D....V....., mbrojtësi i tij avokat Shyqyri Sylja, si dhe i dëmtuarit B....V.....

Pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit të Shtetit, i pandehuri ka deklaruar se e ndjen veten fajtor për veprën penale për të cilën akuzohet, se e kupton natyrën dhe pasojat juridike të pranimin të fajësisë, pranimin e fajësisë e bënë në mënyrë vullnetare, pa presion dhe pas sqarimeve të mjaftueshme nga ana e gjykatës për pasojat dhe benefitet e pranimin të fajësisë dhe i vjen shumë keq për rastin që ka ndodhë, se do të ipte gjithçka nga vetja vetëm që të mund ta rikthente, por kjo nuk është e mundur.

Prokurori i shtetit, lidhur me pranimin e fajësisë nga të akuzuarit, ka deklaruar: se konsideron se janë përmbushur kushtet ligjore për pranimin e fajësisë, pranimi është bërë në mënyrë vullnetare, pa presion, pranimi mbështetet në provat materiale që gjenden në shkresat e lëndës, prandaj i ka propozuar Gjykatës që ta pranoj pranimin e fajësisë, ndërsa sa i përket sanksionit penal i njëjti të shpallet fajtor, të dënohet sipas ligjit duke marrë parasysh të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese.

I dëmtuari B....V.... në shqyrtimin fillestar lidhur me pranimin e fajësisë i ka propozuar gjykatës që të aprovoj pranimin e fajësisë, ndërsa lidhur me sanksionin penal ka theksuar se humbja për të është shumë e madhe, mirëpo fakti që gjykata e dënon apo jo të pandehurin, nuk ia lehtëson dhimbjen, andaj i propozon gjykatës që ta lirojë të pandehurin, përkatësisht të mos dënohet, duke e përsëritur që djali i tij tashmë i ndjerë, ka qenë shumë i lidhur me të pandehurin.

Mbrojtësi i të pandehurit D....V....., avokat Shyqyri Sylja në shqyrtim fillestar dhe lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit ka deklaruar: i mbrojturi i tij pranimin e fajësisë e ka bërë në mënyrë

vullnetare dhe pas konsultimit të mjaftueshëm me të, andaj i ka propozuar gjykatës që ta aprovoj, ndërsa sa i përket sanksionit penal ka kërkuar nga gjykata që të të pandehurin ta shpallë fajtor për veprën që i vihet në barrë, mirëpo konform dispozitës 74 par.1 pika 1.1 të KPRK-së të njëjtin ta liroj nga dënimi, duke pasur parasysh faktin se pasojat e kësaj vepre e kanë goditur rëndë vet të pandehurin, pasi që me të dëmtuarin kanë qenë shumë të lidhur, mirëpo në rastin më të pavolitshëm t'i ketë parasysh rrethanat lehtësuese siç janë, moshë e re, ndërkohë i punësuar, pranimin e fajësisë, faktin që i dëmtuari nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale, se edhe me një dënim të kushtëzuar do të arrihet qëllimi i dënimit..

Gjykata ka shqyrtuar pranimin e fajësisë të cilën e ka deklaruar i pandehuri, e në mbështetje të nenit 242 të KPP-së, në këtë drejtim vlerëson se janë përmbushur kushtet ligjore për pranimin e fajësisë për të njëjtin. Gjykata ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit, mbështetet në provat me të cilat disponon kjo gjykatë si: Deklarata e të pandehurit D....V....., deklarata e të dëmtuarit prindit të ndjerit B....V....., Raporti i Autopsisë me nr. MA22-248, kopja nga dëshmi vdekja, kopja nga Certifikata e vdekjes, Raporti i mjekut nga spitali emergjent në Mitrovicë, rezultati nga alkool testi, Raporti i policit Naim Tahiri, raporti fillestar i Incidentit, fotoalbumi, Raporti i Aksidentit me nr. 2022-BR-463, Ekspertiza e komunikacionit e datës 03.11.2022 si dhe shkresat e tjera të lëndës.

Të gjitha këto prova janë bindëse për gjykatën dhe formojnë elementin inkriminues e që në bazë e tyre dhe pranimin të fajësisë, konstatohet përtej çdo dyshimi se i akuzuari ka kryer veprën penale që i vihet në barrë.

Gjykata ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit është bërë në mënyrë vullnetare dhe se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, duke iu tërhequr vërejtja të pandehurit se pas pranimin të fajësisë, ai nuk mund të bëjë ankesë për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, por vetëm sa i përket llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata ka vërtetuar se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabim faktik, nga këto arsye gjykata e ka aprovuar pranimin e fajësisë të bërë nga i pandehuri.

Gjykata, nga pranimi i fajësisë së të pandehurit dhe nga provat e cekura si më lart, ka vërtetuar përtej çdo dyshimi se i akuzuari D....V..... ka kryer veprën penale: Rrezikimi i trafikut publik nga neni 370 par.9 lidhur me par.6 dhe 1 të KPRK-së, për të cilën veprë është paraparë dënim me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.

Gjykata me rastin e caktimit të dënimit sa i përket kësaj vepre penale, ka aplikuar dispozitat e zbutjes së dënimit, duke qenë se i akuzuari e ka pranuar fajësinë dhe në kuptim të nenit 71 paragrafi 1, nën paragrafi 1.3 të KPRK-së, kjo është rrethanë ligjore për zbutjen e dënimit. Me rastin e zbutjes së dënimit janë respektuar kufijtë e zbutjes, sipas nenit 72 paragrafi 1, nën paragrafi 1.5 të KPRK-së. Andaj në kuptim të nenit 49 paragrafi 2 të KPRK-së, janë plotësuar kushtet për shqiptimin e dënimit me kusht.

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka pasur parasysh vlerësimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese për matjen e dënimit në mbështetje të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së. Si rrethana rënduese gjykata ka vlerësuar rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale. Ndërsa, si rrethana lehtësuese gjykata e ka vlerësuar pranimin e fajësisë në tërësi për veprën penale, faktin se i njëjti ka shprehur keqardhje të sinqertë, gjithashtu faktin se nga shkresat e lëndës rezultojnë se i pandehuri me të dëmtuarin, ishin në raporte familjare dhe se siç e ka konfirmuar edhe pala e dëmtuar, të njëjtit (pra i pandehuri dhe viktimi), ishin shumë të afërt mes tyre dhe se ky rast, e ka goditur jashtëzakonisht shumë edhe vet të pandehurin, si dhe moshën e re të pandehurit.

Duke marrë parasysh të gjitha këto rrethana si dhe shkallën e rrezikshmërisë shoqërore, gjykata vlerëson se shqiptimi i dënimit me burgim me kusht ndaj të pandehurit, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë të të pandehurit. Po ashtu, Gjkata vlerëson se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38 të KPRK-së, që t'i parandaloj kryerësit nga kryerja e veprës penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre, si dhe të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprës penale si dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit. Po ashtu, ky dënim do të shërbejë si masë preventive që në të ardhmen i pandehuri të përmbahet nga çfarëdo veprimi që është i dëmshëm për shoqërinë në përgjithësi.

Vendimin për shpenzimet e procedurës gjykata e ka marrë në bazë të nenit 449, 450 dhe 452 të KPP-së, që kanë të bëjnë me shpenzimet e paushallit gjyqësor dhe shpenzimet për përpilimin e ekspertizës së komunikacionit, ndërsa taksa për kompensimin viktimave të krimit, në kuptim të nenit 36 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 të Ligjit nr.08\L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Sa i përket kërkesës pasurore juridike, gjykata ka vendosur duke u bazuar në nenin 460 par.1 të KPP-së, pasi që i dëmtuari ka hequr dorë nga kërkesa pasurore juridike.

Andaj, gjykata, duke u bazuar me 364, 449, 450, 452 dhe 460 të KPP – së, nga arsyet e lartcekura ka vendosur si ne dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**  
**Departamenti i Përgjithshëm**  
**P.nr.88/2023, datë 12.03.2024**

Procesmbajtësja  
Doruntina BEKA

Gjyqtari  
Xhemajl JUSUFI

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij Aktgjykimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e pranimit të Aktgjykimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për gjykatën dhe palët kundërshtare.